

STATUTI

I SHOQËRISË “COOP-MARKET-LAPARDHAJA” SH.P.K.

Në bazë të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “ Për Tregtarët dhe Shoqërit Tregtare” si dhe ligjit Nr.9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” me vullnetin tone të lirë, duke u mbështetur edhe në Aktin-Themelimit që i bashkëngjitet këtij statuti, Ne Ortaket Themelues:

1. Ilia Londos i biri i Nikolaus-it i datelindjes 08.07.1975 i identifikuar me dokumentin Karte Identiteti ID:031508594 dhe Numer Personal H50708052J banues - Rruga "Antipatrea" Lagja “Çlirim” shtëpi private "3KT" ne Bashkine Berat.
2. Aleks Mbrati i biri i Petrit-it i datëlindjes 21.09.1975 i identifikuar me dokumentin Karte Identiteti ID:024638320 dhe Numer Personal E30810047E, banues - shtëpi private "3KT" nr.1, Rruga "Sali Bori" Lagja “28-Nentori” Bashkia Ure-Vajgurore.
3. Feruzan Mbrati i biri i Petrit-it i datëlindjes 18.02.1980 i identifikuar me dokumentin Karte Identiteti ID:024637898 dhe Numer Personal I00218002F, banues - shtëpi private "3KT" nr.2, Rruga "Sali Bori" Lagja “28-Nentori” Bashkia Ure-Vajgurore.

me zotësi të plotë juridike për të vepruar, vendosem të hartojmë këtë Statut të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**COOP-MARKET-LAPARDHAJA**” sh.p.k. si më poshtë vijon:

FORMIMI I SHOQËRISË


Neni 1

Ne ortaket themelues: Ilia Londos, Aleks Mbrati dhe Feruzan Mbrati, në bazë të Aktit – Themelimit të nënshkruar prej nesh, kemi themeluar shoqërin me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “**COOP-MARKET-LAPARDHAJA**” sh.p.k.

FORMA E SHOQËRISË

Neni 2

Shoqëria “**COOP-MARKET-LAPARDHAJA**” sh.p.k., është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të ortakeve në kapitalin e themelimit.



QËNDRA, TERRITORI Neni 3

Selia e shoqërisë **“COOP-MARKET-LAPARDHAJA” sh.p.k.** ndodhet ndodhet ne fshatin “Lapardha 1”, godine 3-KT me pasuri nr.859, zona kadastrale 1587, njesia Administrative Otlak, Bashkia Berat.

Shoqëria mund të hapë edhe filiale, përfaqësi, agjensi operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Me miratim të organeve kompetente shtetërore, shoqëria, mund të hapë dhe filiale, degë, përfaqësi, agjensi të saj edhe jashtë vendit.

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË Neni 4

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë tregtare **“COOP-MARKET-LAPARDHAJA” sh.p.k.** do të jetë me afat të pacaktuar dhe mbi 10 vjet, duke filluar ky afat nga dita e regjistrimit të shoqërisë si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, duke kryer më parë të gjitha veprimet e likuidimit sipas dispozitave ligjore në fuqi.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË Neni 5

Selia e shoqërisë **“COOP-MARKET-LAPARDHAJA” sh.p.k.** ndodhet ndodhet ne fshatin “Lapardha 1”, godine 3-KT me pasuri nr.859, zona kadastrale 1587, njesia Administrative Otlak, Bashkia Berat, do të jetë:

1. Tregtim te mallrave ushqimore, pijeve freskuese, pijeve alkolike dhe mallrave industriale, detergjente, kozmetik, higjenik etj. me shumic e pakic.
2. Tregtim te frutave, perimeve, produkteve bujqesore e blegtorale me shumic e pakic.
3. Tregtim te mishrave (perpunuar e paketuar), te mishit te pules dhe nenprodukteve te tij me shumic e pakic.
4. Tregtim te mallrave te ndryshem industrial me shumic e pakic
5. Sherbimi i transportit per mallra, brenda dhe jashte vendit per vehte dhe te trete.
6. Importe – Eksporte.

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë i rregjistruar është 10.000.000 (dhjete million) lekë dhe është kontribut i ortakeve themelues të shoqërisë ne mjete monetare.

Vlera e kapitalit të rregjistruar të shoqërisë është 10.000.000 lekë dhe është kontribut i ortakeve themelues të shoqërisë si: Ortaku Ilia Londos vlera e pjesës së kapitalit është 5.000.000 lekë, Ortaku Aleks Mbrati vlera e pjesës së kapitalit është 2.500.000 lekë dhe Ortaku Feruzan Mbrati vlera e pjesës së kapitalit është 2.500.000 lekë.

Vlera e kapitalit themeltar është në tre kuota me vlera totale të kapitalit 10.000.000 lekë, kuotat e kapitalit zoterohen nga ortakët themelues si vijon: ortakët themelues z. Ilia Londos ka një kuotë me vlerë nominale të kuotës 50% të kapitalit të shoqërisë ose 5.000.000 lekë; ortakët themelues z. Aleks Mbrati ka një kuotë me vlerë nominale të kuotës 25% të kapitalit të shoqërisë ose 2.500.000 lekë dhe ortakët themelues z. Feruzan Mbrati ka një kuotë me vlerë nominale të kuotës 25% të kapitalit të shoqërisë ose 2.500.000 lekë.

Vlera e kapitalit të rregjistruar të papaguar në shumën 10.000.000 lekë do të derdhet në llogarit bankare të shoqërisë brenda 30 ditëve kalendarike nga momenti i rregjistrimit të shoqërisë nga ortakët themelues.

Kapitali themeltar mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimit të Asamblesë së Ortakeve.

Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkruheshëm.

Pjesët e kapitalit themeltar janë plotësisht të transferueshme në rrugë trashëgimie, por ato mund t'u transferohen personave të tretë, që nuk bëjnë pjesë në ortakëri, por gjithmonë me vendim të Asamblesë së Ortakeve dhe me akt noterial, konform ligjit.

Fitimi që do të realizohet gjatë veprimtarisë ekonomike të shoqërisë do të administrohet nga Asambleja e Ortakeve. Një pjesë e këtij fitimi do të përdoret për investime dhe zgjerimin e aktivitetit tregtar.

Ky fitim do të disponohet lirisht prej Asamblesë së Ortakeve, pasi shoqëria të ketë shlyer më parë detyrimet ligjore.

Për kryerjen e veprimtarisë së saj, shoqëria do të hap njësi prodhimi, shërbimi, tregtimi dhe do të bashkëpunojë me persona fizikë e juridik vendas dhe të huaj.

Shoqëria mund të ushtrojë dhe aktivitete të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi, të konsideruara me përfitim dhe të dobishme për arritjen e objektivave të saj kryesore.

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI

Neni 7

Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë, emëron si Administrator të shoqërisë **“COOP-MARKET-LAPARDHAJA”** sh.p.k. z. Feruzan Mbrati, me afat për 5 (pesë) vjet, afat i cili fillon menjëherë me regjistrimin e shoqërisë si person juridik në Q.K.B, për periudhën 02.07.2020 deri 02.07.2025.

Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë është organi më i lartë drejtues dhe vendimor i shoqërisë, ai ushtron të gjitha kompetencat që i jep ligji "Për tregtarët dhe shoqërit tregtare".

Me vendim të Asamblese së Ortakeve të Shoqërisë mund të zgjerohet duke pranuar një ose më shumë ortakë të tjerë, shtetas shqiptarë apo të huaj ose të bashkohet me një shoqëri tjetër tregtare brenda dhe jashtë vendit.

Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë mund t'ia delegojë kompetencat një ose më shumë administratorëve të emëruar prej tij ose dhe një personi fizik jashtë ortakërisë së shoqërisë, vetëm mbi bazën e prokurës noteriale.

Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë ka kompetencë të emërojë si administrator edhe një person tjetër jashtë shoqërisë, duke i caktuar atij pagën dhe detyrat e tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me statutin e kësaj shoqërie. Afati i emërimit nuk mund të jetë më i gjatë se 5 (pesë) vjet dhe mund të rizgjidhet.

Administratori, i emëruar nga Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë, e humbet detyrën e tij me rastin e prishjes së shoqërisë ose në çdo kohë me vendim të Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë. Të gjitha vendimet e shoqërisë merren nga Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë ka kompetencë të emërojë dhe shkarkojë Ekspertin e autorizuar të shoqërisë. I cili ben auditimin e llogarive të shoqërisë, duke i caktuar atij pagën dhe detyrat e tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me statutin e kësaj shoqërie.

Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë i merr të gjitha vendimet e saj duke i pasqyruar me shkrim dhe nenshkrimin e të gjithë ortakëve të saj në këto vendime.

ADMINISTRATORI I SHOQËRISË

Neni 8

Administratori i shoqërisë ka këto kompetenca:

- ↓ Organizon dhe drejton veprimtarinë operative të shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi, Aktin e Themelimit dhe Statutin.
- ↓ Administron pasurinë e shoqërisë.
- ↓ Disponon firmën në llogaritë përkatëse të shoqërisë në bankë.
- ↓ Përfaqëson shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët.
- ↓ Vendos për marrjen në punë dhe largimin nga puna të punonjësve të shoqërisë, nxjerrjen e tyre në asistencë, si dhe mënyrën e shpërblimit të tyre, cakton dhe jep lejet e zakonshme. Mban regjistrin themeltar të punonjësve, evidenton punën e tyre dhe kur është rasti merr masat disiplinore sipas ligjit.

- ✚ Ndjek ritmikisht aktivitetin ekonomik të shoqërisë, si dhe cakton kontabilistin për mbajtjen e kontabilitetit të shoqërisë.
- ✚ Mban përgjegjësi për likuidimet në kohë të detyrimeve të shoqërisë ndaj shtetit sipas legjislacionit fiskal dhe të detyrimeve ndaj palëve të treta.
- ✚ Përfaqëson shoqërin para organeve gjyqësore dhe administrative ose autorizon personat e tjerë kompetentë.
- ✚ Kryen veprime juridike në emër dhe për llogari të shoqërisë me të tretët si: lidh kontrata, kryen veprime të ndryshme bankare, doganore, tregtare, financiare dhe cdo veprimtari tjetër kontraktore ose jashtë kontraktore që është në interes të shoqërisë dhe cdo veprim tjetër që parashikohet në ligj.
- ✚ Administratorit të shoqërisë i ndalohet marrja e kredive në banke, overdrafteve bankare, marrja e borxheve tek të tretët, dhënia e huave për të tretë nga mjetet monetare të shoqërisë, pa marrë miratimin paraprak me pare nga Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë.

VITI FINANCIAR DHE LLOGARITË VJETORE

Neni 9

Çdo vit financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor.

Përgjashtimisht viti i parë financiar ka filluar ditën e themelimit si person juridik.

Llogaritë vjetore, inventari, raporti mbi veprimtarin e vitit financiar të hartuar nga administratori, kontabilisti i miratuar apo eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë.

Bilanci vjetor i shoqërisë nxirret brenda datës 31 Marsë të vitit pasardhës.

Shoqëria **"COOP-MARKET-LAPARDHAJA"** sh.p.k. të ardhurat e saj do të realizojë nga ushtrimi i veprimtarisë private të saj.

Çmimet dhe tarifat e shërbimeve caktohen me vendim të Asamblese së Ortakeve të shoqërisë dhe në përputhje me kërkesë - ofertën dhe dispozitat ligjore në fuqi.

MARRËDHËNIET E PUNËS

Neni 10

Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

Për problemet që nuk parashikohen në kontratë zbatohen dispozitat e ligjore në fuqi të ligjit "Kodi i Punës në R.SH."

Shoqëria **"COOP-MARKET-LAPARDHAJA"** sh.p.k. merr përsipër të respektojë të gjitha rregullat në fuqi të sigurimeve shoqërore e shëndetsore, ndërsa punonjësit detyrohen të respektojnë aktet ligjore në fuqi, këtë statut dhe kontratën e punës.

Të punësuarit në këtë shoqëri përgjigjen para ligjit dhe këtij statuti për mos respektimin e detyrave dhe për dëmet e shkaktuara. Të gjithë punonjësit janë të detyruar të ruajnë sekretin e shoqërisë dhe pas largimit nga kjo shoqëri.

SHPËRBËRJA E SHOQËRISË

Neni 11

Shpërbërja e shoqërisë bëhet në çdo kohë dhe për cdo lloj shkak.
Shoqëria priset para kohe kur:

1. Aktiviteti ekonomik i saj për disa vjet radhazi është me humbje.
2. Për arsye të parashikuara nga ligji.
3. Dhe në çdo rastë tjetër me vendim të Asamblese se Ortakeve te Shoqerise.

Mënyra e likuidimit të shoqërisë është kompetencë ekskluzive e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise. Asamblea e Ortakeve te Shoqerise cakton një ose më shumë likuidator për të nxjerrë rezultatet e aktivitetit të shoqërisë.

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 12

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar **“COOP-MARKET-LAPARDHAJA”** sh.p.k. fiton personalitet juridik nga dita e rregjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Shoqëria është person juridik Shqiptar dhe zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me normat e legjislacionit Shqiptar në fuqi, me Statutin dhe Akt-Themelimin e saj.

Neni 13

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar **“COOP-MARKET-LAPARDHAJA”** sh.p.k. është person juridik i pavarur. Ajo ka të drejta dhe detyrime për të cilat përgjigjet me ligj.

Neni 14

Asamblea e Ortakeve te Shoqërisë ka të drejtë që në përputhje me ushtrimin e veprimtarisë së tij, të bëjë ndryshime në këtë Statutë.

Neni 15

Shoqëria do të ketë vulën e saj. Vula do të mbajë stemën dhe shkrimet e nevojshme që tregojnë emrin e shoqërisë.

Neni 16

Për të gjitha mos marrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që nuk zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetentë për zgjidhjen e tyre është Gjykata ku ndodhet selia ligjore e shoqërisë.


Neni 17

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut në lidhje me kompetencat e Asamblese së Ortakeve të Shoqërisë dhe të gjitha kushteve të tjera do të bazohet në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqërit Tregtare" si dhe ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" me ndryshimet përkatëse.

PËR SHOQËRIN "COOP-MARKET-LAPARDHAJA" SH.P.K.

ORTAKET THEMELUES

ILIA LONDOS



ALEKS MBRATI



FERUZAN MBRATI



Berat, me 02.07.2020